



IOM International Organization for Migration
IOM Internationale Organisation für Migration

Dezember 2009
Albanisch

REAG-/GARP-Program 2010

Reintegration and **E**migration Program for **A**sylum-Seekers in **G**ermany (**REAG**)
Government **A**ssisted **R**epatriation Program (**GARP**)

Program i Qeverisë Gjermane dhe i Landëve dedikuar emigrantëve të cilet kanë nevojë për ndihmë financiare

Fletëinformimi

A. Informacione të përgjithshme

REAG (shpenzimet për udhëtim) dhe GARP (ndihmë plotësuese) është program ndihmës humanitar. Ky program iu dedikohet personave që dëshirojnë me vullnet dhe vetëdëshire të kthehen në vendlindje. IOM-i ju ofron "Ndihmë Fillestare" dhe luan rol aktiv në zhvillimin dhe lëvizjen e emigrationit.

REAG / GARP organizohet nga ana e IOM-it në emër të Ministrisë së Mbrendshme, Ministrive të Landëve dhe në bashkëpunim me Zyrat Komunale, Qendrat për Keshilla - juridike, Qendrat për kthim të refugjatëve si dhe me Komisionin e Lartë për refugjatë nga ana e Kombeve të bashkuara (UNHCR).

Ky Program në menyrë të rregullt dhe kompetente organizon kthimin vullnetar dhe emigrimin në vende tjera. Kushti paraprak është që personit që dëshiron të rikthehet në vendlindje nuk ka mjete të domosdoshme për udhëtim ose personi që me ligj është i detyruar ta ndihmojë nuk ka të ardhura ose ndonjë Organizatë tjetër bene kerkesen për të. Kjo kërkesë mund të parashtrohet në Qendrat Sociale ose në ndonjë Qendrat tjera. Në raste se dëshironi të emigroni në një shtet tjetër, së pari duhet të dëshmoni vizën e rregullt.

B. Ndihmat:

Në kuadër të këtij programi mund të parashtrohet keto kërkesa:

- Shpenzimet për udhëtim (me Aeroplan, Tren ose Autobus)
- Shpenzimet për karburant nëse udhëtoni me makinë: në shumë prej **250,00 €**
- Ndihme udhëtimi në shume prej **200,00 €** për të rritur ose deri në **100,00 €** për fëmijë deri në moshën 12 vjet.
- **GARP-ndihme fillestare: 400,00 €** për të rritur dhe **200,00 €** për fëmijë deri në moshën 12 vjeqare për shtetasit nga: Bosnja dhe Hercegovina, Mali i Zi, Maqedoni, Serbia dhe Kosova (me perjashtim nga minoritetet nga Kosova: serbe dhe rome).
- **GARP-ndihmë plotësuese fillestare: 750,00 €** për një të rritur dhe **375,00 €** për fëmijë deri në moshën 12 vjeqare për minoritetet nga Kosova: serbe dhe rome

Stand: Januar 2009

IOM - Verbindungsstelle bei der Regierung der Bundesrepublik Deutschland:

Charlottenstr. 17 • D-10117 Berlin • Germany
Tel: +49.30.278 778 0 • Fax: +49.30.278 778 99

IOM - Vertretung in Nürnberg:

Postfach 440159 • D-90206 Nürnberg • Frankenstraße 210 • D-90461 Nürnberg • Deutschland
Tel: +49.911.43 00 0 • Fax: +49.911.43 00 260

E-mail: IOM-Germany@iom.int • Internet: <http://www.iom.int/germany>

Bankverbindung: Deutsche Bank Bonn • BLZ 380 700 59 • Kto.-Nr. 1 360 031

C. Parashtrimi i kërkesës

Kërkesa për REAG/GARP mund të bëhet në Zyrat Komunale dhe të Landëve (p.sh. Qendër Sociale, në Zyrën për shtetas të huaj), Shoqatat joqeveritare si dhe me Komisionin e Lartë për refugjatë nga ana e Kombëve të bashkuara (UNHCR).

D. Rreti i personave dhe parakushtet

Ndihma REAG dhe GARP iu dedikohen këtyre personave:

- Ata që marrin ndihme ne baze te ligjit § 1 për azilkërkesit
- Atyre që iu është i njohur statusi si refugjatë
- Shtetasit e huaj të cilet kanë të drejte qendrimi në baza humanitare apo në arsy politike
- Viktimat nga Prostitucioni apo tregtija me njerëz

Të gjithë duhet të kenë së paku një „Grenzübertrittsbescheinigung“ = „vërtetim për kalim të kufirit“ para se të udhetojnë. Ata që kthehen në Kosovë mund të iu lëshohet një „EU-Laissez- Passer“ dhe „Dokumenti për vize“ = „Rückkehrvignette“

Ai që benë kërkesen duhet të verifikoj në REAG/GARP se me dëshiren e tij kerkon të kthehet në vendlindje dhe se jep dorë nga statusi për qëndrim. Po të ketë ndonjë dyshim se prap do te kthehet ne Republken Federale Gjermane, atij do të i refuzohet kërkesa. Me anën ligjore nuk mund te parashtrohet ankesa per mosndihme ndaj IOM-it.

Shtetasit nga Bashkesia Europiane nuk kanë te drejte të parashtrjnë kërkesë për REAG dhe GARP. Perjashtim te kesaj rregulle jane: viktimat nga prostitucioni apo tregtja me njerëz.

E. Viza për migrante

Të huajt të cilët dëshirojnë të udhëtojnë në një vend tjetër, është e udhës së pari të marrin këshilla në Zyret për emigration (p.sh. Raphaels-Werk, Diakonisches Werk, DRK(Kryqi i Kuq gjerman)). Adresarin për këshilla mund të i merrni në:

Bundesverwaltungsamt

Informationsstelle für Auswanderer und Auslandstätige

50728 Köln

(www.bundesverwaltungsamt.de)

Kërkesat nga ana e IOM-it mut të parashtrohet pasi të mirret viza nga shteti i tretë në të cilën deshironi të emigroni.

F. Informatione tjera më plotësuese

Informatione tjera më plotësuese për REAG/GARP Programin mund të i merrni në Qndrat Sociale dhe Zyrat për shtetas të huaj si dhe drejtëpërdrejt nga IOM.-i në Nürnberg (në gjuhen gjermane dhe angleze).

G. Program special për migrantet të cilet marrin përsiper vetë shpenzimet e udhëtimi mit (SMAP)

IOM-i iu ofron një program special SMAP (Special Migrants Assistance Program) atyre personave të cilët nuk mund të finanziahet nga programi REAG/GARP. Ne mund të organizojmë fluturimin dhe cmime të lira për ju.

Kjo vlenë për personat që udhëtojnë në SHBA / Kanadë / Australi. Bileta duhet të paguhet para udhëtimit ose ndonjë Zyre bën kërkesën për ju dhe merr përsiper shpenzimet për udhëtim (p.sh. Qendra sociale, Shoqatat humanitare, etj.).